

## Njësia për të Drejtat e Njeriut

### Aktivitetet e NJDNJ: për periudhën Janar - Qershor 2016

Në kuadër të aktiviteteve dhe përgjegjësi, Njësia për të Drejtat e Njeriut ka bërë monitorimin e zbatimit të Ligjeve, akteve nënligjore, rregulloreve, strategjive dhe planet e veprimit të miratuara nga Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës si dhe planet e strategjitë komunale për trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët, shërbime që ofron administrata komunale, përdorimin e gjuhëve zyrtare, përkthimin e dokumentacionit, mbledhjeve e takime të tjera në gjuhë zyrtare, trajtimin shëndetësor, edukim, punësim, ndihma sociale e të tjera.

Si mekanizëm përgjegjës promovon dhe mbron të drejtat e njeriut në nivelin komunal.

Janë monitoruar seancat e Kuvendit, Komiteteve dhe takime të tjera të komunës.

Njësia për të drejtat e njeriut ka mbajtur takime të rregullta me Institucionin e Avokatit të Popullit, me Komisionin Parlamentar për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe të pagjeturit, Divizionin për të drejtat e njeriut-MAPL, Zyrën për Qeverisje të Mirë-Zyra e Kryeministrit, me Agjencionin për Barazi Gjinore si dhe organizata të ndryshme vendore e ndërkombëtare të cilat merren me të drejtat e njeriut.

Komiteti për Barazi Gjinore, Njësia për të drejtat e njeriut dhe zyrtarët e tjerë komunal shënuan “8 Marsin” ditën ndërkombëtare të gruas.

Gjate muajit maj 2016 zyrtarët e NJDNJ kanë marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga CDF-USAID për rolin dhe përgjegjësinë e komunës për të përfshirë publikun në planifikimin e buxhetit komunal ku gjithashtu u bë edhe punë në grupe për identifikimin e sfidave dhe rekomandimeve për pjesëmarrje me të lartë të qytetarëve në vendim – marrje komunale.

Gjithashtu gjatë muajit maj zyrtarja për barazi gjinore ka marrë pjesë në trajnimin dy ditor (26-27 maj) të organizuar nga RTC-consulting- USAID për aftësitë menaxhuese, shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve dhe shkathtësitë e vendimmarrjes brenda rolit dhe përgjegjësi të ZBGJ.

Në fund të muajit maj 2016 në Gjilan u mbajt tryeza e organizuar nga ABGJ në bashkëpunim me OSBE-në me temë: “Ligji për barazi gjinore” miratuar nga Parlamenti i R.Kosovës, ku morën pjesë zyrtarë nga NJDNJ dhe zyrtarë të tjetër të komunës.

Më 9 dhe 10 qershor zyrtarët e NJDNJ morën pjesë në trajnimin dy ditor të organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) me temë “Të drejtat e Njeriut dhe vetëqeverisja lokale në Kosovë”. Gjatë këtij trajnimi u diskutua rreth zhvillimit historik të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Sa i përket të drejtave të fëmijëve NJDNJ ka promovuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas Konventës për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Gjatë muajit mars organizuar nga zyra e kryeministrit ZQM në bashkëpunim me UNICEF-in është mbajtur takim konsultativ me përfaqësuesit e komunave Gjilan,

Kamenice, Ferizaj, Viti, Kaçanik dhe Ranilluk me temë: “ Fushat prioritare të Strategjisë dhe Plani i Veprimit për të drejtat e Fëmijëve në Kosovë”.

Më 22 prill 2016 u shënua Dita Ndërkombëtare e Tokës ku në disa pjesë të qytetit u mbollën lule dhe fidane.

Janë zhvilluar aktivitete të shumta kundër dukurive negative, janë realizuar vizita nëpër shkolla, çerdhe, QPS dhe QMF.

Për nder të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve “1 Qershori” NJDNJ organizoi aktivitetet të ndryshme me nxënësit e shkollave dhe çerdheve të Komunës së Gjilanit ku pjesëmarrës ishin edhe Asambleja Komunale e Fëmijëve. Gjatë manifestimit gjithashtu u shpërndanë fletëpalosje dhe u zhvilluan lojëra të ndryshme nën mbështetjen e Zyrës së Kryetarit të Komunës, organizatës “Save the Children” dhe OJQ “Syri Vizion” nga Peja.

Në 6 mujorin e vitit 2016 janë organizuar aktivitete nga NJDNJ me qëllim të fuqizimit të Asamblesë së Fëmijëve.

Sipas memorandumit të mirëkuptimit në mes të GIZ-projekti për të drejtat sociale për grupet vunerabël-SOR-i- Prishtinë dhe Komuna e Gjilanit të nënshkruar nga GIZ-znj.Brigitte Koller Keller dhe Kryetari i Komunës z.Lutfi Haziri me qëllim që të identifikoj rolin dhe përgjegjësitë e secilës palë në implementimin e projektit të GIZ-it, SOR-i ku si objektive kanë përmirësimin e kushteve për sigurimin e të drejtave të barabarta sociale për grupet në nevojë.

Me vendim të kryetarit të komunës është themeluar grupi punues në përbërje nga përfaqësuesit e NJDNJ-së dhe zyrtarë të tjerë nga drejtoritë komunave dhe zyrat e komunës, për implementimin e projektit “Të drejtat sociale për grupet vunerabël/ të marginalizuara -SOR-i.

Gjatë muajt Prill GIZ- i ka organizuar trajnim 1 ditor me grupet punuese të Gjilanit, Prishtinës, Ferizajit, Drenasit dhe Prizrenit dhe përfaqësues nga MAPL me temë “Të drejtat e Njeriut, të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore në Kosovë”.

Gjatë muajit maj 2016 GIZ-i organizoi një trajnim në Durrës të R.Shqipërisë me grupet e 5 komunave, përfaqësuesit e MAPL, Zyra Ligjore e Kryeministrit të R.Kosovës me temë “ Pakoja Ligjore: Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për Avokatin e Popullit dhe Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi” si dhe janë zhvilluar takime me 3 komunat nga R.Shqipërisë : Elbasan, Librazhd dhe Kukës të cilat janë të kyçura në të njëjtin projekt të GIZ-it ku edhe u shkëmbyen përvoja mes komunave të dy shteteve.

Grupi punues ka organizuar takime me OJQ-të e Komunës së Gjilanit dhe ka bërë thirrje për aplikim me projekte të OJQ-ve në financim të aktiviteteve ndërlidhur me promovimin dhe avancimin e të drejtave sociale. Thirrjes iu janë përgjigjur disa OJQ me draft -projekte. Grupi punues në bashkëpunim me GIZ-in shqyrtuan draft-projektet e ofruara nga OJQ-të me ç’rast edhe e përzgjedhën projektin më të mirë të OJQ-së Qendra psikologjike “Aponija” me titull “ Të ndryshojmë duke vepruar”.

Gjilan, më 08 korrik 2016.